



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 301/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.08.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave standarte të tenderit për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-63158-06-29-2020, me objekt “*Kite dhe Reagentë për Laboratorët*”, me fond limit 2.090.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.

**Ankimues:** “Krijon” sh.p.k.  
Rruga e Elbasanit, nr. 57, Çollak, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor** Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër  
Rruga: “Bujar Bishanaku”, Shkodër

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.06.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-63158-06-29-2020, me objekt “*Kite dhe Reagentë për Laboratorët*”, me fond limit 2.090.000 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 06.07.2020, operatori ekonomik “Krijon” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

[...]

1. *Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3. kapaciteti teknik*
2. *1- Pika II,2 kërkohet “Çertifikatë konformiteti me standartet CE, çertifikatë e konformitetit për kite dhe reagent për prodhuesin e mallrave të ofruar”, tipi i çertifikatës së kërkuar nuk është i vlefshëm për gjithë artikujt e kërkuar në listën e DST, mbasi ka artikujt që nuk kanë CE.*

*Kërkojmë të ndryshohet pika II, 2, në pikën 2.3. Kapaciteti teknik, dhe të bëhet:*

*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autodeklaratën për materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat CE 93/42/EEC ose 98/79 EEC kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e çertifikatave përkatëse CE/DC (Deklaratë konformiteti) bazuar në praktikën e prokurimeve që kryhen nga institucionet kryesore të fushës si QSUT, SUSM “Shefqet Ndroqi”, etj. praktikën e prokurimeve të cilave janë publikuar në APP.*

*2- Pika II, 5, kërkohet “Autorizim nga Prodhuesi ose distributori i Autorizuar nga Prodhuesi për shitje, tregtimin dhe suportin e mallrave dhe shërbimeve të ofruara në territorin e Shqipërisë. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit. Për kitet e ujit Autorizimi duhet të jetë i specifikuar për procedurë tenderuese.*

*Kjo kërkesë është tërësisht e paargumentuar dhe është vendosur për të favorizuar vetëm një kompani dhe për të eliminuar konkurrencën në këtë procedurë prokurimi. Kjo bie ndesh në mënyrë të hapur me rekomandimin e APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 ku përcakton se autoritetet kontraktore duhet të mirëpërcaktojnë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter.*

*Kompanitë prodhuese u lëshojnë distributorëve seriozë autorizime vjetore të vlefshme për gjithë prokurimet e periudhës, nuk ka arsye të kërkohet autorizim specifik.*

*Kërkojmë heqjen e kësaj pike nga kriteret e kualifikimit duke pranuar edhe autorizime prodhuesi apo distributori afatgjata.*

*3- Pika II, 5, kërkohet “Ofertues duhet të paraqesi fletëpalosje (Packed insert ose MSDS) e secilit kit për spektrofotometrin në të cilën të jenë të përshkruar specifikimet e secilit kit si dhe prodhuesi”.*

*Dokumenti i kërkuar nuk ka lidhje me cilësinë e produktit apo me specifikimet e tij. Specifikimet e kiteve jepen në katalogun e kompanisë prodhuese. MSDS është një dokument që lidhet me sigurinë e manipulimit të produktit apo me rrezikshmërinë e produktit në transport, ky dokument shoqëron mallin dhe mund të paraqitet në lëvrimin e mallit. Ky dokument mund të dorëzohet pasi është blerë malli ose produkti dhe është e pamundur për ta pasur në dispozicion përveç ndonjë kompanie e cila mund ta ketë blerë dhe ta ketë gjendje këtë produkt. Përsa shpjeguam më sipër kjo kërkesë përbën diskriminim për operatorët të cilët nuk mund të kenë parablërë produktin i cili shoqërohet me këtë dokument. Vëmë në dukje se ky dokument kërkohet në mënyrë të panevojshme dhe nuk është kërkuar më parë nga institucioni juaj.*

*Kërkojmë heqjen e kësaj pike nga kriteret e kualifikimit dhe të kalojnë si dokumenta që shoqërojnë mallin në momentin e lëvrimin për të gjithë reagentët e listës së tenderit.*

*4- Në shtojcën e specifikimeve teknike pika 3, është kërkuar “Mallrat të jenë të ambalazhuar me ambalazh kartoni, plastik ose qelqi sipas natyrës së mallit, të mbyllur hermetikisht, me etiketë ku të shënohen në paketimin e tyre emërtimin, origjinën e prodhimit, datën e prodhimit, datën e skadencës mbi dy vjet (për ato produkte që kanë afate skadence), cilësinë, sasinë, përbërja kimike”.*

*Vëmë në dukje se edhe produktet që kanë afat skadence jo të gjithë e kanë jetëgjatësinë (afatin nga data e prodhimit në datën e skadencës) mbi dy vjet sepse kjo varet nga lloji i produktit të prokuruar.*

*Ndaj kërkojmë që afati i skadencës të jetë “1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës” pasi ka artikuj që nuk e kanë jetëgjatësinë 2 vjet.*

*Referuar ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, neni 46 pika 3 përcaktohet [...].*

*Si edhe neni 20 “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.*  
*[...].*

II.3. Operatori ekonomik ankimues sqaron se në datën 13.07.2020 është vënë në dijeni për shkresën me nr. 544/1 prot., datë 08.07.2020 të autoritetit kontraktor për kthimin e përgjigjes për ankesën e paraqitur prej tij pranë këtij të fundit (duke mos vërtetuar faktin e marrjes dijeni për shkresën në datën 13.07.2020). Gjithashtu ankimuesi sqaron se në datën 10.07.2020 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar shtojca me modifikimet përkatëse pasi disa nga pretendimet e ankimuesit janë pranuar nga autoriteti kontraktor.

II.4. Në datën 16.07.2020, operatori ekonomik ankimues ka depozituar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e kriterëve të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi dhe konkretisht duke ngritur pretendime për:

*Pika II, 5, dhe Shtojcën për ndryshimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkohet “Ofertuesi duhet të paraqesi fletëpalosje (Packed insert ose MSDS) e secilit kit për spektrofotometrin në të cilën të jenë të përshkruar specifikimet e secilit kit si dhe prodhuesi”.*

*Dokumenti i kërkuar nuk ka lidhje me cilësinë e produktit apo me specifikimet e tij. Specifikimet e kiteve jepen në katalogun e kompanisë prodhuese, dokument i mjaftueshëm për të verifikuar specifikimet teknike të kërkuara në DST. Fletëpalosja është manuali i përdorimit të kitit ndërsa MSDS është një dokument që lidhet me sigurinë gjatë punës me këtë kit apo me rrezikshmërinë e produktit në transport, këto dokumenta shoqërojnë mallin dhe mund të paraqitet në lëvrimin e mallit. Këto dokumenta mund të dorëzohet pasi është blerë malli ose produkti dhe është e pamundur për ta pasur në dispozicion përveç ndonjë kompanie e cila mund ti ketë blerë dhe ti ketë gjendje këto produkt. Përsa shpjeguar më sipër kjo kërkesë përbën diskriminim për operatorët të cilët nuk mund të kenë parablërë produktin i cili shoqërohet me këtë dokument. Vëmë në dukje se këto dokumenta kërkohet në mënyrë të panevojshme dhe për herë të parë nga një institucion në gjithë historikun 20 vjeçar të prokurimeve në sektorin e shëndetësisë. Gjithashtu MSDS kërkohet vetëm për kitet e spektrofotometrave (të cilat kanë rrezikshmëri të ulët) dhe nuk është kërkuar për reagentët kimikë të rrezikshëm të listës së tenderit (psh artikujt 13, 14, 16, 19, 25, 27, 28, 29, 30, 31, 32 etj.)*

*Kërkojmë heqjen e kësaj pike nga kriteret e kualifikimit dhe të kalojnë si dokumenta që shoqërojnë mallin në momentin e lëvrimit për të gjithë reagentët e listës së tenderit.*

*dhe nuk është kërkuar më parë nga institucioni juaj.*

*Kërkojmë heqjen e kësaj pike nga kriteret e kualifikimit dhe të kalojnë si dokumenta që shoqërojnë mallin në momentin e lëvrimit për të gjithë reagentët e listës së tenderit.*

*Vëmë në dukje se kjo pikë ka qenë çështja kryesore për të cilën jemi ankimuar pranë institucionit.*

*Kërkojmë pranimin e kërkesës për ndryshimin e kritereve të shpallura në DST lidhur me procedurën me objekt “Blerje kite dhe reagent për laboratorët”.*

II.5. Me shkresën me nr. 615 prot, datë 27.07.2020, protokolluar me tonën me nr. 786/2 prot, datë 30.07.2020, me objekt “Shkresë përcjellëse” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për fletëpalosjet (Packed insert ose MSDS), Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika II-5, paragrafi 2 dhe paragrafi 3, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret si më poshtë vijon:

- *Të paraqiten katalogët e produkteve me të dhënat teknike për artikujt e ofruar. Në katalog, të shënohet secili nga artikujt e ofruar (katalogët kërkohen në mënyrë elektronike).*
- *Ofertues duhet të paraqesi fletëpalosjet (Packed insert ose MSDS ) e secilit kit për spektrofotometrin në të cilën të jenë të përshkruar specifikimet e secilit kit si dhe prodhuesi.*

III.1.2. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar ankimuesit për ankesën e paraqitur pranë tij, argumenton se:

*“AK në DST kërkon që “Ofertuesi duhet të paraqesë fletëpalosjet e secilit kit për spektrofotometrin në të cilën të jenë të përshkruar specifikimet e secilit kit si dhe prodhuesi. Kjo fletëpalosje (dokument me informacione teknike) mund të jetë ose Packed insert ose MSDS në vartësi të specifikave që mund të ketë secili prodhues. Ajo që kërkohet është që këto dokumenta të përshkruhet specifikimet e secilit kit si dhe prodhues, se çfarë produkte do të*

*ofrohen, nga cili prodhues do të ofrohen, çfarë parametra teknike ka produkti dhe çfarë kushte mjedisi do vendosen dhe përshtaten me pajisjet ekzistuese”.*

III.1.3. Në informacionin dhe dokumentacionin e autoritetit kontraktor të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është paraqitur edhe dokumenti me emërtimin “Procesverbal i Njesisë së Prokurimit”, i mbajtur në datën 29.06.2020, në të cilin rezulton se nuk është argumentuar vendosja e këtij kriteri.

III.1.4. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se :

*“1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;*

*b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

III.1.5. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.*

III.1.6. Në nenin 27, pika 6 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

III.1.7. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.9. Sa më sipër, KPP gjykon se, për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që nëpërmjet kërkesave dhe kriterëve të hartuara në dokumentat e tenderit, si edhe specifikimeve teknike të përcaktuara, të lejohet pjesëmarrja e një numri të gjerë konkurentësh me qëllim përfitimin e një malli me performancë të lartë e me çmim të ulët.

III.1.10. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar Komisioni vlerëson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret, KPP konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar dy kritere të cilat referuar edhe kthimit të përgjigjes së vetë autoritetit kontraktor drejtuar ankimesit, shërbejnë “për të përshkruar specifikimet e secilit kit si dhe prodhues, se çfarë produkte do të ofrohen, nga cili prodhues do të ofrohen, çfarë parametra teknike ka produkti dhe çfarë kushte mjedisi do vendosen dhe përshtaten me pajisjet ekzistuese”, pra qëllimi i autoritetit kontraktor është që nëpërmjet kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit të arrijë të verifikojë specifikimet teknike të produktit si dhe prodhuesin e tij, gjë e cila arrihet të provohet më së miri me kriterin *“Të paraqiten katalogët e produkteve me të dhënat teknike për artikujt e ofruar. Në katalog, të shënohet secili nga artikujt e ofruar (katalogët kërkohen në mënyrë elektronike)”.*

III.1.11. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor nuk duhet të përcaktojë kritere që mbivendosin njëri tjetrin e për më tepër shkaktojnë konfuzion e paqartësi si tek operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit gjatë hartimit të ofertave të tyre, ashtu edhe tek autoriteti kontraktor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Në rastin konkret, qëllimi i kriterit të cilin kundërshton ankimesi, është për të verifikuar specifikimet teknike të produktit dhe prodhuesin, kjo referuar përgjigjes së vetë autoritetit kontraktor, fakt ky që provohet më së miri me kërkesën për katalogët të cilët përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Për më tepër, në dokumentat e tenderit, referuar procesverbalit të hartimit të dokumentave të tenderit të mbajtur nga autoriteti kontraktor në datën 29.06.2020, konstatohet se ky përcaktim nuk është argumentuar dhe justifikuar nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është mëse e mjaftueshme që operatori ekonomik të paraqesë katalogët nëpërmjet të cilëve vërtetohen më së miri specifikimet teknike si edhe prodhuesi i produktit.

III.1.12. Në këtë kuptim Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke e hequr përcaktimin për kërkesën për fletëpalosje me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili, parashikon shprehimisht se:

2. *Qëllimi i këtij ligji është:*

a) *të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*

b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

d) *të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

dh) *të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar kushte kufizuese sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjerë të operatorëve ekonomikë.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentat e tenderit duke e hequr kriterin në lidhje me fletëpalosjet si të tepërt dhe i ekzagjeruar.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumentave të tenderit duke hequri kriterin e mësipërm.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Krijon” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-63158-06-29-2020, me objekt “Kite dhe Reagentë për Laboratorët”, me fond limit 2.090.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.07.2020, nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik si më sipër cituar.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.



4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Krijon” sh.p.k.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 786 Protokolli,**

**Datë 16.07.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**